



Planimë / Dokument Prilidhjen / Prilidhjen Received / Delivered		26.04.2023	3	with good Votat
Organ / Shkencë Org / Shkencë Org / Shkencë	Id / Prot Id / Prot Id / Prot	Shitja e Prisje Appendix	Sasia Kohëzgjatë Quantity	
SKIMSHEK	3835/2023		117	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.493/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.493/2023 të datës 13.03.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 26.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.493/2023 e datës 13.03.2023, e parashtruar nga ankuesi.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.Ref:42/2023 i datës 14.02.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesi (tutje vetëm ankuesi) më datë 13.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.Ref:42/2023 të datës 14.02.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, shkëljes së të drejtës materiale dhe procedurale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa kjo e fundit më datë 29.03.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar kësaj

çështje juridiko-administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2597/2023 të datës 13.03.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Listën e pyetjeve të përshkruar nga ankuesi në intervistë me gojë; Ankesën e datës 09.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në KVLB/MPJD; Kërkesën e datës 24.11.2022; Njoftimin e rezultateve përfundimtare të verifikimit paraprak i datës 31.01.2023; Kërkesën për qasje në dokumente publike e datës 06.02.2023 nga ankuesi; Vendimin me Nr.ref: 21/2023 i datës 31.01.2023 për themelimin e Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë; Listën e intervistës me gojë e datës 03.02.2023; Raportin-Aktin përfundimtar i datës 03.02.2023; Konkursin me Nr. Reference: RN0010636 i datës 23.12.2022 për pozitën Zyrtar i Lartë për Diplomaci Publike dhe Digjitale; Procesverbalin e pyetjeve të parashtruara në intervistë me gojë; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 03.02.2023; Njoftimin nga Burimet Njerëzore në MPJD për ankuesin i datës 03.02.2023; Njoftimin për kandidatin fitues i datës 03.02.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 2999/2023 e datës 27.03.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 3092/2023 e datës 29.03.2023; Listën e aplikantëve të pranuar; Vendimin e datës 23.01.2023 për verifikim paraprak për ankuesin dhe kandidaten ; Njoftimin e datës 23.01.2023 për verifikim paraprak; Emailin e datës 23.01.2023 nga Burimet Njerëzore/MPJD për ankuesin; Lista me detaje të vlerësimit të aplikantit për ankuesin dhe kandidaten ; Vendimin e datës 03.02.2023 për përfundimin e konkurrimit dhe shpallja e rezultatit; Emailin e datës 06.02.2023 nga Burimet Njerëzore/MPJD për ; Aplikacionin e kandidates së bahsku me dokumentacionin si Diplomën me Nr. 5615 të datës 11.07.2018; Certifikatën e trajnimit e datës 16.10.2020; Certifikatën e trajnimit e datës 19.12.2019; Aktin Emërimin .Nr.32/2022 i datës 13.06.2022; Dokument identifikimi për ; Formulari i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm i datës 26.10.2021, 11.01.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 20.01.2023; Vërtetimin me Nr. 13/2023 i datës 20.01.2023; Aplikacionin e ankuesit së bashku me dokumentacionin si Diplomën me Nr.1293 e datës 06.12.2011; Diplomën me Nr.289 e datës 03.09.2012; Certifikatën për periudhën 25-28.09.2007; Certifikatën për periudhën tetor 2008 deri janar 2009; Certifikatën e trajnimit nëntor deri dhjetor 2009; Certifikatën e trajnimit mars 2010; Mirënjohjen maj 2011; Certifikatën për periudhën 28.11.2010 deri 28.03.2011; Certifikatën për periudhën 04.04.2011 deri 30.06.2011; Vërtetimin e lëshuar nga Avokat Vendim Ref.Nr.411/09 i datës 07.04.2009; Certifikatën për kryerje të praktikës për periudhën 01.06-04.07.2009; Mirënjohje e datës 04.04.2009; Njoftimi i mandatarëve i datës 13.09.2010; Vërtetimin e datës 28.12.2017; Akt Emërimin e datës 11.04.2018; Akt Emërimin .Nr.02/234 i datës 07.06.2021; Referencë e datës 18.09.2009; Letër Rekomandim; Kopje e ID-së; Formularët për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 31.01.2022, 21.12.2020, 31.05.2021 dhe 06.01.2019; Dëshmi/Vërtetim i datës 07.12.2022; Vendimin me Nr. Ref:42/2023 i datës 14.02.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Deklaratat nën betim të datës 29.03.2023 të anëtarëve të Komisionit për Vlerësim për Lëvizje brenda Kategorisë, e-mailin e datës 26.04.2023 të MPB/DMZP.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 23.12.2022 ka publikuar Konkursin me numër reference RN00010636 për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Diplomaci Publike dhe Digjitale, klasa profesional 2, një pozitë*, me afat të aplikimit 09.01.2023 deri 20.01.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar dhe ankuesi, i cili është përfshirë në të gjitha fazat e procedurës, mirëpo që i njëjti bazuar në vlerësimin e Komisionit për lëvizje brenda kategorisë (tutje KLBK) i themeluar sipas Vendimit Nr.ref.21.2023 të datës 31.01.2023 është vlerësuar me gjithsej 51.8 pikë, duke u renditur si kandidati i dytë. Kurse sipas Njoftimit me numër protokoll 525 të datës 03.02.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore kandidatja e suksesshme për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Diplomaci Publike dhe Digjitale*, është shpallur kandidatja me gjithsej 83.2 pikë.

Ankuesi i pakënaqur me vlerësimin e KLBK, më datë 06.02.2022 ka parashtruar ankesë pranë këtij Komisioni, ndërsa ky i fundit me Vendimin Nr.ref:42/2023 të datës 14.02.2023 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke kundërshtuar ligjshmërinë e Vendimit Nr.Ref:42/2023 të datës 14.02.2023 të KLBK, me pretendimet ankimore së gjatë zhvillimit të procedurës për lëvizje brenda kategorisë sipas Konkursit me numër reference RN00010636 për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Diplomaci Publike dhe Digjitale* në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka pasur shkelje të ligjit material dhe procedural, sepse renditja e kandidatëve në fazën e verifikimit paraprak nuk është bërë sipas rendit alfabetik; Komisioni për lëvizje brenda kategorisë nuk ka arritur të bëjë vlerësimin e jetëshkrimit, edhe se me rastin e intervistës me gojë ka bërë ndryshimin e pyetjeve në raport me pyetjet që janë përcaktuar që do t'u parashtrohen kandidatëve. Me tej ankuesi shton së nuk është bërë njoftimi për çdo fazë të vlerësimit por ka njoftuar vetëm me rezultatin përfundimtar, dhe së njoftimi për kandidatin fitues është bërë në ditën e intervistës në kundërshtim me nenin 51 paragrafi 1 të Rregullores Nr. (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Propozon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj në tërësi procedurën e rekrutimit për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Diplomaci Publike dhe Digjitale* në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Referuar Konkursit me numër reference RN00010636 si kushtet për lëvizjen brenda kategorisë janë përcaktuar: *Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale. Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende. Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit. Ndërsa si kërkesa të përgjithshme formale janë kërkuar: **Arsimi i kërkuar: Diplomë të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to në Arte, Juridik, Diplomaci, Dizajn Grafik (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim i Diplomës Bachelor). Përvoja e punës së kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.***

Në kuptim të shqyrtimit të bazueshmerisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore lidhur me procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, përkatësisht:

Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë - Neni 38 me të cilin është përcaktuar se: "1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni....5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës".

Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës – Neni 41 ka përcaktuar se: 1. Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurimit. 2. Kushtet që duhet ti plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurrimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit. Neni 44 më të cilin është përcaktuar se: "1.Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidateve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje...". Neni 45 më të cilin është përcaktuar se: "1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin". Neni 47 përcakton se: "1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pike". Neni 48 me të cilin përcaktohet se: "...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbliidhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbliidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbëjnë vlerësimin përfundimtar të konkurrimit...". Neni 49 me të cilin përcaktohet se: "1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njesisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk

është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues..”.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur së nuk qëndron pretendimi ankimor i ankuesit se në rastin e verifikimit paraprak dhe përpilimit të listës së ngushtë, Njësia e Burimeve Njerëzore të MPJD-së, ka vepruar në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse sipas listës së aplikanteve (pa datë dhe numër) renditja e kandidatëve që u është aprovuar aplikacioni si dhe të atyre që u është refuzuar aplikacioni është bërë në renditje alfabetike, dhe rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit mos renditja e kandidateve sipas rendit alfabetik është çështje e natyrës teknike dhe si e tillë nuk përben ndonjë shkelje esenciale të procedurës dhe e cila mund ta cenoj ligjshmërinë e procesit.

Kolegji i Këshillit lidhur me konstatimin e pretendimit ankimor së Komisioni për lëvizje brenda kategorisë me rastin e intervistës ka bërë ndryshimin e pyetjeve në raport me pyetjet që janë përcaktuar që do t’u parashtrihen kandidatëve, përmes kërkesës për përgjigje në ankesë të datës 27.03.2023 ka kërkuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës respektivisht nga Komisioni i Vlerësimit të Lëvizjes Brenda Kategorisë deklaratë nën betim lidhur me këtë pretendim të ankuesit, ndërsa anëtarët e KVLBK më datë 29.03.2023 kanë nënshkruar deklaratën nën betim përmes të cilës pohojnë se *“pyetjet kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatët dhe të njëjtat janë përgatitur ditën e zhvillimit të intervistës”*. Rrjedhimisht, referuar këtij pretendimi ankimor, Kolegji i Këshillit me asnjë shkresë nuk ka arritur të provoj faktin nëse anëtarët e Komisionit kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 47 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Përkitazi me pretendimin ankimor së njoftimi për kandidatin fitues është bërë në ditën e intervistës pra në kundërshtim me nenin 51 paragrafi 1 të Rregullores Nr. (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur së intervista me gojë është bërë më datë 03.02.2023 dhe së po në këtë datë është publikuar edhe Njoftimi më numër protokollit 525 i datës 03.02.2023 për kandidatin fitues, veprim ky që bie ndesh me nenin 51 paragrafi 1 të Rregullores Nr. (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mirëpo, në vlerësimin e Kolegjit ky tejkallim procedural nuk ka krijuar ndonjë rrethanë të diskriminimit në raport me ankuesin apo rrethane të favorizimit të kandidatit tjetër, ngase ankuesit i është dhënë e drejta e ankesës dhe se parashtrimi i ankesës nga ana e palës ankuese ka pamundësuar që njoftimi për kandidatin fitues të behët përfundimtar në kuptim të nenit 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku është përcaktuar se: *“Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankesë pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankesë pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën.*

Ndërlidhur me pretendimin ankimor se Komisioni për lëvizje brenda kategorisë nuk ka arritur të bëjë vlerësimin e jetëshkrimit, Kolegji në vështrim të dispozitave të nenit 47 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku thuhet se: *KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës,*

KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi, ka konstatuar së vlerësimi i kandidateve nëpërmjet intervistës të procedura e lëvizjes brenda kategorisë është vlerësim gjithëpërfshirës, duke nënkuptuar vlerësimin e përbashkët të jetëshkrimit, aftësive dhe njohurive për pozitën përkatëse, pra, mbi këtë bazë, rrjedh së jetëshkrimi të intervista me gojë, nuk është fazë e veçantë e vlerësimit sikurse parashihet të procedura e pranimit dhe procedura e ngritjes në detyrë sipas nenit 22 dhe 58 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës .

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor se nuk është bërë njoftimi për çdo fazë të vlerësimit, Kolegji i Këshillit thekson faktin së Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore-SIMBNJ mundëson informim e kandidatëve me çdo veprim dhe fazë të procedurës së konkurrimit, kështu që pretendimi ankimor mbi këtë bazë nuk ka mbështetje ligjore.

Në kuptim të parimit për emërim në shërbim civil mbi bazën e meritës dhe aftësisë profesionale, Kolegji i Këshillit ka analizuar dokumentacionin e aplikimit të ankuesit dhe kandidatës fituese nga dhe ka konstatuar së ankuesi dhe kandidatja e suksesshme kanë plotësuar në tërësi kushtet për lëvizjen brenda kategorisë pasi që sipas dokumentacionit të aplikimit që të dy kandidatet janë nëpunës civilë të njëjtës kategori për të cilën aplikojnë, janë nëpunës civil të konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale, nuk janë të ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende si dhe kanë vlerësime 'mire' të rezultateve në punës, të paktën për dy viteve te fundit të vlerësimit. Ndërsa, lidhu me kërkesat e përgjithshme formale, Kolegji nga analizimi i provave të lëndës ka gjetur së ankuesi posedon Diplomën me numër 1293 të datës 06.12.2011 të lëshuar nga Fakulteti Juridik të Universitetit të Prishtinës, më të cilën dëshmohet së ka përfunduar studimet themelore më datë 13.02.2009 në Fakultetin Juridik dhe ka marr titull Bachelor i Drejtësisë, me gjithsej 180 pikë-ECTS, dhe Diplomën nr. 289 të datës 03.09.2012 të lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës më të cilën dëshmohet së ankuesi më datë 21.06.2012 ka përfunduar studimet master dhe ka marrë gradën Master i Shkencave Juridike, ndërsa lidhur me përvojën profesionale të punës posedon Vërtetimin (pa numër dhe datë) të lëshuar nga Avokat sipas të cili është vërtetuar së ankuesi ka qenë i angazhuar si ndihmës profesional(lidhur me këtë përvojë punë nuk përmban kontratë punë apo vërtetim nga organet kompetent si Trusti apo ATK), Vërtetimin e datës 28.12.2017 të lëshuar nga kompania me emër tregtar " Water Supply and Sewerage Prishtina II" sipas të cilit rrjedhë së ankuesi ka punuar në pozitën e juristit pranë kësaj kompanie për periudhën nga data 01.04.2014 deri me 01.08.2017, (po ashtu lidhur me këtë përvojë punë ankuesi nuk përmban kontratë punë apo vërtetim nga organet kompetent si Trusti apo ATK), Akt emërimin më numër 1976 të datës 11.04.2018 më të cilën dëshmohet së ankuesi ka ushtruar pozitën e Zyrtarit të Lartë për Bashkëpunim Profesional në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për periudhën nga data 11.04.2018 deri qershor 2021, si dhe Akt Emërimin Nr.02/34 të datës 2021 sipas të cilit rezulton së ankuesi nga data 07.06.2021 është emëruar dhe ushtron pozitën e punës Zyrtar i Lartë Ligjor në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve. Ndërsa, kandidatja posedon Diplomën më numër 5615 të datës 11.07.2018 të lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetit "Hasan Prishtina", më të cilën dëshmohet së e njëjta ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik dhe ka marr titullin Jurist i Diplomuar-Bachelor,240 pikë-ECT, kurse lidhur me përvojën e punës bazuar në vërtetimin nr.13/2023 të datës 20.01.2023 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MPJD-së rezulton së ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Punëve të

Jashtësme dhe Diasporës që nga data 20.09.2018 në pozitën e punës Zyrtare Administrative. Andaj, bazuar në këto fakte rrjedhë se ankuesi dhe kandidatja e suksesshme kanë plotësuar kushte e përgjithshme formale lidhur me pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Diplomaci Publike dhe Digjital*, mirëpo bazuar në vlerësimin e intervistës më gojë, kandidatja është vlerësuar me gjithsej 83.2 pikë, duke u renditur si kandidatja me më shumë pikë, ndërsa ankuesi është vlerësuar me gjithsej 51.8 pikë duke u renditur si kandidati i dytë, kështu që mbi këtë konstatim Kolegji vlerëson se Njësia e Burimeve Njerëzore ka vepruar në pajtim me nenin 49 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës më të cilin është përcaktuar se: *"Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurrimi..."*.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit në mbështetje të dispozitave të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.493/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.